



Datë: 07.07.2025

Numër Protokolli: 4649/2025

A.nr.760/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.760/2025 të datës 29.04.2025 të parashtruar nga ankuesi I.M, kundër organit të punësimit/Ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “transferim pas rristrukurimit” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.760/2025, e datës 29.04.2025 e parashtruar nga ankuesi I.M.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 374, i datës 18.03.2025, i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrit të Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil I.M (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi) më datë 29.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit 374, të datës 18.03.2025 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, lidhur me transferimin e tij pas rristrukurimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa Këshilli më datë 19.06.2025 ka pranuar nga kjo e fundit përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Tutje, Kryetari i Këshillit, me vendim me numër protokolli 3995/2025, të datës 12.06.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr. 760/2025, të parashtruar nga ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune, lidhur me ankesën e ankuesit I.M .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2818/2025 e parashtruar nga ankuesja më datën 29.04.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopje e letërnjoftimit për I.M; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 06.12.2011, për ankuesin I.M; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 06.12.2014, për ankuesin I.M; Akt Emërimi i datës 07.12.2014, për I.M; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Asistent i Logjistikës”; Vendimin Nr.374 e datës 18.03.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 07.05.2025, dërguar përmes emailit nga R.K, për H.K; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 760/2025, e datës 19.06.2025; Raportin e punës Nr.191 të Komisionit të Ristrukturimit të MMPHI-së; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për I.M; Diplomë e datës 01.09.1988, për ankuesin I.M; Vendimi i datës 12.06.2025, i Këshillit;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 07.12.2015, është i punësuar në pozitën e punës “Asistent i Logjistikes”, në kuadër të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturë, kurse ndaj të njëjtit Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ka nxjerrë Vendimin me shifër Nr.374 i datës 18.03.2025 përmes të cilit ankuesin e ka transferuar në pozitën “Asistent i Logjistikes”, në Divizionin e Logjistikes dhe Mirëmbajtjes, në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, respektivisht DMZP-ja, nxjerrjen e vendimit për transfer sipas detyrës zyrtare e ka mbështetur në Raportin e Punës Nr.191 të datës 03.03.2025 të Komisionit të Ristrukturimit për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon se procedura e ristrukturimit dhe lëshimit i aktit të kontestuar të datës 18.03.2025, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, shkelje esenciale të dispozitave materiale dhe shkelje esenciale të dispozitave procedurale, me pretendimet ankimore kundër Vendimit 374, të datës 18.03.2025 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, lidhur me transferimin e tij pas ristrukturimit sepse nga viti 2009 jam i punësuar në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturë, dhe se pasi që institucioni ka kaluar fazën e ristrukturimit me datë 01.04.2025, përmes emailit kam pranuar vendimin 374, të datës 18.03.2025, ku nga pozita “Asistent i Logjistikes”, jam ri caktuar në pozitën “Asistent i Logjistikes”, duke pretenduar se edhe përkundër përshkrimit të detyrave të punës jam ngarkuar edhe me detyra shtesë dhe se më datën 15.11.2024, përmes shkresës me numër protokolli 7547, kam kërkuar shtesë prej 20%, të pagës por asnjëherë nuk është ekzekutuara.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit lidhur me të drejtën e tij të sistemimit për shkak të riorganizimit, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi*

përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësuese të institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës...

Po ashtu Kolegji ju referuar edhe Rregullores (QRK) NR. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, respektivisht nenit 12, ku përcaktohet: “1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Shuarja apo ristrukturimi i institucionit përcaktohet në legjislacionin përkatës për organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura. 3. Transferimi sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 3.1. në të njëjtin institucion; 3.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë, apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 3.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 3.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 4. Transferimi bëhet sipas radhës së përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni. Nëse nuk ka pozita të lira të së njëjtës kategori apo nëpunësi nuk plotëson kërkesat e pozitës së punës në të njëjtin institucion sipas nën paragrafit 3.1. të këtij neni, transferimi i tij mund të bëhet në institucionin tjetër sipas radhës së përcaktuar në paragrafin 3. 5. Nëpunësit e institucionit të ristrukturuar njoftohen individualisht nga NjMBNj për fillimin e procedurës së transferimit për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit. Njoftimi bëhet menjëherë pas miratimit të aktit të ristrukturimit të institucionit”.

Rrjedhimisht, bazuar në dispozitat e lartë theksuara ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se me hyrjen në fuqi të Rregullores (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimit të Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka pasuar me shuarje të pozitave, ndryshime në emërtime të pozitave përkatëse si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kriterëve të punës për pozita të caktuara, ndërsa pozita e ankuesit Asistent i Logjistikës, me këtë rregullore është emërtuar Asistent i Logjistikës -Klasa Profesional 3, dhe atë si pozitë e vetme brenda Divizionit të Logjistikës dhe Mirëmbajtjes, në Departamentin e shërbimeve të Përgjithshme dhe Teknologjisë Informative, ashtu që duke marrë parasysh se ankuesi ka plotësuar kriteret e posaçme lidhur me arsimimin, përvojën dhe kualifikimet, i njëjti me të drejtë sipas Komisionit të Ristrukturimit është propozuar të risistemohet në të njëjtën pozitë, andaj pretendimet e ankuesit janë të pa qëndrueshme dhe të paqarta, ngase kjo pozitë pune në të cilën është transferuar apo risistemuar i njëjti, hynë në pozitat e shërbimit civil, e cila është renditur me nr. 64 të Rregullores (QRK) nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të punës në Shërbimin Civil, e vendosur në Grupi i administrimit të përgjithshëm, si dhe kërkesa arsimore është përcaktuar: Arsim i mesëm i paspecifikuar ashtu siç është përcaktuara edhe me rregulloren e brendshme të organit përkatës të punësimit, gjegjësisht në Grup i Administrimit të Përgjithshëm dhe se ankuesi nuk është dëmtuar sa i përket pagës.

Si rrjedhojë, Kolegji i Këshillit konstaton se edhe pretendimi ankimor i ankuesit, është i pa qëndrueshëm ngase e njëjti sipas shkresave të lëndës rezulton se nuk plotëson kërkesat e posaçme për ngritjen në pozitë apo kërkesës lidhur me kualifikimin arsimor, sepse posedon Diplomë me numër protokolli 2209, të datës 01.09.1988, të lëshuar nga SH.M.E.J ‘Hoxhë Kadri’, Prishtina , me çka dëshmohet se ka përfunduar Shkollën e Mesme Profesionale, Ekonomik –Juridik andaj Kolegji i Këshillit pasi ka analizuar përgatitjen profesionale të ankuesit ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i pa bazuar në ligj.

Kolegji i Këshillit mbi bazën e konstatimeve si më lartë, vlerëson së Komisioni i Ristrukturimit në rastin e ankueses ka vepruar në pajtim me 66 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenet 13, 14 dhe 15 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, andaj, përkitazi me ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar me ankesë respektivisht kundër Vendimit me numër 374, të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministritë së Punëve të Brendshme Kolegji i Këshillit, konstaton se ky vendim është nxjerr në pajtim me nenin 66 paragrafi 4 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe në pajtim me dispozitat e nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë dhe po ashtu ky vendim përmban elementet të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse akti i kundërshtuar me ankesë përmban dispozitiv të qartë dhe arsyetim konkret, kështu që pretendimet e ankuesit janë të pabazuara, ngase, në rastin konkret të ankueses nuk janë cenuar parimet e sigurisë juridike në raport me marrëdhënien e saj të punës, ngase i njëjti është risistemuar në kategorinë dhe klasën e njëjtë, për të cilën plotëson kriteret e posaçme.

Kolegji i Këshillit i ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se edhe përkundër përshkrimit të detyrave të punës jam ngarkuar edhe me detyra shtesë dhe se më datën 15.11.2024, përmes shkresës me numër protokolli 7547, kam kërkuar shtesë prej 20%, të pagës por asnjëherë nuk është ekzekutuara, me qëllimin të shqyrtimit të këtij pretendimi ka kërkuar prova lidhur me këtë pretendim nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, ndërsa Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, me datë 23.06.2026, përmes emalit ka dërguar provë listën e pagave për ankuesin I.M, me çka dëshmohet se ankuesi ka realizuar kompensimin e shtesave për shkak të vëllimit të punës me vlerën 10% në shumën prej 496.10€, andaj bazuar në këtë konstatim sa i përket kompensimin të pagesës për vëllim të shtuar të punës, Kolegji i Këshillit konstaton se e njëjta realizohet, ndërsa Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar në shqyrtimin e ligjshmërisë së kërkesës së datës 15.11.2024, përmes shkresës me numër protokolli 7547, sepse e njëjta është jashtë afateve ligjore të parapara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.760/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit I.M;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë;
- Arkivit të KPMSHCK-së.